



PËRDITËSIM

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara, i cili, këtë javë ndryshe nga herët e tjera po mbahet të premtën, sepse jo vetëm që dëshirojmë t'ju ofrojmë përditësime mbi zhvillimet më të fundit në Gjykatë, por dëshirojmë edhe t'ju japim mundësinë të bëni pyetje lidhur me shqiptimin e aktgjyqimit ditën e sotme, në çështjen gjyqësore *Salih Mustafa*.

Trupi Gjyqësor I sot, më 16 dhjetor 2022, shqiptoi aktgjykimin në këtë çështje gjyqësore, saktësisht tre muaj pas mbylljes së çështjes.

Trupi Gjyqësor e shpalli z. Mustafa fajtor për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme dhe e dënoi me 26 vjet burgim. Për arsye ligjore, Trupi Gjyqësor e shpalli z. Mustafa të pafajshëm për krimin e trajtimit mizor

Kur shqiptoi vendimin, Trupi Gjyqësor nënvizoi se akuzat në këtë çështje gjyqësore kanë të bëjnë vetëm me përgjegjësinë penale individuale të z. Mustafa dhe përfshirjen e tij në krimet e pretenduara të luftës të ndalimit arbitrar, trajtimit mizor, torturës dhe vrasjes së paligjshme të viktimave.

Trupi Gjyqësor gjithashtu shpalli se do të nxjerrë urdhër për zhdëmtim më pas.

Në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët*, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, dje, më 15 dhjetor, ia kaloi dosjen e çështjes Trupit Gjyqësor II. Pas marrjes së dosjes, Trupi Gjyqësor planifikoi konferencën mbi ecurinë e çështjes për ditën e sotme, 16 dhjetor, për të diskutuar aspektet teknike me palët në kuadër të përgatitjes së gjyqimit. Konferenca mbi ecurinë e çështjes është duke u mbajtur aktualisht dhe mund të përcillet me 45 minuta vonesë përmes faqes së internetit në tri gjuhët e gjykatës, shqipe, serbishte dhe anglishte.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 12 dhjetor, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori Vendimin e Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave", me anë të të cilit pranoi 14 viktima pjesëmarrëse në procesin gjyqësor. Ai nuk pranoi 20 kërkesa të tjera pasi krimet e pretenduara nga të cilat këta parashtrues bënë të ditur se kishin vuajtur, nuk përkonin me vendet dhe periudhat e përmendura në Aktakuzë. Në Vendim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nënvizoi se përfundimet e tij nuk paragjykojnë asnjë kërkesë të ardhshme dhe as vendimet përkatëse mbi pranueshmërinë e tyre.

Ky vendim, e çon numrin e gjithsejtë të viktimave pjesëmarrëse në gjykimin *Thaçi dhe të tjerët*, në 53. Gjykatësi i Procedurës Paraprake përcaktoi se viktimat e pranuar me vendimin më të fundit do t'i bashkohen grupit ekzistues të viktimave pjesëmarrëse në proces dhe do të përfaqësohen nga i njëjti mbrojtës viktimash.





Një numër kërkesash të tjera nga viktimat për të marrë pjesë në procesin e kësaj çështje gjyqësore janë ende në pritje të vendimit mbi pranueshmërinë e tyre. Më 9 dhjetor, u dorëzua “Raporti i Dhjetë i Zyrës Administrative drejtuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi Kërkesat e Viktimave për Pjesëmarrje në Proces” i cili përmban rekomandime për gjykatësin lidhur me 10 kërkesa të tjera.

Si vendimi i fundit i Gjykatësit të Procedurës Paraprake, ashtu dhe raporti i fundit i Zyrës Administrative gjenden në faqen e internetit të DHSK-së.

Ky informim javor është i fundit për këtë vit pasi të hënën, më 19 dhjetor, fillon pushimi i gjykatës. Gjykata do të jetë në funksionim gjatë periudhës së pushimit të gjykatës dhe puna do të vijojë si zakonisht në të gjitha njësitë e DHSK-së. Informimi i parë javor për vitin e ardhshëm do të mbahet të enjten, më 12 janar 2023.

Pyetje nga gazetarët

Një gazetar pyeti për mundësinë për z. Mustafa që të apelojë aktgjykimin

Zëdhënësja shpjegoi se cilado nga palët mund ta apelojë aktgjykimin dhe në qoftë se një palë vendos të paraqesë apel, atëherë brenda tridhjetë ditësh duhet të dorëzojë njoftimin e apelit. Në vijim Kryetarja e Dhomave të Specializuara cakton Panelin e Apelit prej tre gjykatësish të cilët nuk kanë marrë pjesë në Trupin Gjyqësor. Gjatë procedurës së apelit, avokatët e personit të dënuar, viktimat pjesëmarrëse, sipas rastit dhe ZPS-ja kanë mundësinë të paraqesin argumente juridike me shkrim. Palët ose pjesëmarrësit mund të paraqesin përgjigje ndaj këtyre argumenteve. Gjithashtu, gjykatësit mund të vendosin të mbajnë seanca publike në të cilat avokatët e personit të dënuar, viktimat pjesëmarrëse, sipas rastit dhe ZPS-ja mund t'i paraqesin argumentet e tyre gojarisht.

Një gazetar pyeti ku do ta kryente dënimin z. Mustafa

Zëdhënësja shpjegoi se vetëm kur aktgjykimin merr formë të prerë në pajtim me kornizën ligjore të DHSK-së, kur Kryetarja e DHSK-së, pasi ka dëgjuar personin e dënuar, cakton shtetin ku do të vuajë dënimin. Ndërkohë, në lidhje me hapat e ardhshëm të mundshëm në këtë çështje, ligji përcakton se secila prej palëve mund të apelojë aktgjykimin mbi bazën e (i) një pretendimi për gabim juridik; (2) një pretendimi për gabim faktik që ka shkaktuar gabim gjyqësor; ose (iii) një pretendimi për gabim në dënimin e dhënë

